



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. 031/01-0057372/më 15-03-2017
12

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L -040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMIT PUBLIK TË RREGULLORËS PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS

I. Miratohet Vendimi për formimin e komisionit për zhvillimin e diskutimit publik të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Prishtinës.

II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Angjelina Krasniqi - Konsulentë e HELVETAS, kryesuese
2. Fadil Leci - Shef i sektorit të bashkësive lokale, anëtar
3. Edona Bislimi - zyrtare ligjore, anëtare

III. Detyra e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që të kujdesët për zhvillimin e diskutimit publik të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Prishtinës, të shqyrtojë të gjitha ankesat, vërejtjet dhe sugjerimet e publikut të bëra gjatë diskutimit publik.

IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Ju dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.



Kryetari i Komunës
Shpend Ahmeti